

AKT- THEMELIMI

I SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE

KUFIZUAR

“BIG BELSHI” Sh.p.k.

Midis:

1. Shoqeria **“BIGALB GROUP” shpk.** Person Juridik shqiptar i regjistruar si i tille prane Regjistrimit Tregetar ne QKR, pajisur me Nipt **L11521002M dhe seli ne Tirane, Vaqarr, Fshati Gropaj, Godina Tirana Cash & Carry, kati 2.** Me perfaqesuese Ligjore Znj. Elona Koshi, e bija e Tekiut, e dtl. 04.09.1986, e lindur ne Gramsh dhe banuese ne Tirane Rruga “3 Deshmoret”, Yzberisht. Madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 033400499 leshuar me date 06.06.2017.
2. **Robert HOXHA**, i biri i Skenderit, i datelindjes 11.06.1979, lindur ne Librazhd dhe banues ne Tirane, Rr. “Viktor Eftimiu” Lagjja “Vasil Shanto” pallati i ri, perballe ish KESH-it. Madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, me dokument identifikimi (ID Card) Nr. 030596521 dhe nr. Personal H90611075R leshuar me date 21.01.2011.

Ne baze te legjislacionit shqiptar kane vendosur me vullnetin e tyre te lire dhe te plote, marrevshjen per themelimin e shoqerise tregtare private, me pergjegjesi te kufizuar, te emertuar **“BIG BELSHI” Sh.p.k.** e cila do te rregullohet ne mbeshtetje te ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” si dhe ligji Nr.9723 date 03.05.2007 “Per regjistrimin e biznesit” i ndryshuar, si dhe te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe normave qe vijojne:

Neni 1

Te themeloje nje shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar e quajtur “Big Belshi” Sh.p.k. “Big Belshi” Sh.p.k. eshte nje subjekt juridik Shqiptar, te cilit i lind e drejta te ushtroje aktivitetin qe nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB). Shoqeria “Big Belshi” Sh.p.k. zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin Shqiptar dhe me aktet e themelimit te saj.

Neni 2

Shoqeria do te jete e formes se Shoqerive tregtare me pergjegjesi te kufizuar dhe perballon humbjet sipas ligjit.

Neni 3

Objekti i aktivitetit ekonomik te shoqerise do te jete:

- Import-eksport, tregetimin e artikujve te ndryshem te te gjitha llojeve, me shumice dhe pakice si:
- Tregetim artikuj te ndryshem industrial.
- Tregetim artikuj te ndryshem ushqimore.

- Tregetim artikuj te ndryshem bujqesore e blegtorale.
- Tregetim fruta-perime.
- Tregetim pije alkolike te ndryshme.
- Tregetim konfeksione te ndryshme per te rritur dhe femije.
- Tregetim prodhimesh kozmetike e estetike.
- Transport mallrash te te gjitha llojeve brenda dhe jashte vendit.
- Tregetim automjetesh te cdo lloji, marke e tonazhi, si dhe pjese kembimi per to.
- Tregetim, montim, riparim paisjesh elektro-shtepiake, elektronike, elektrike, kompjuterike, higjeno-sanitare dhe hidraulike, prodhime qeramike, artizanati, pajisje zyresh etj.
- Hapje dhe shfrytezim hotelesh, motelesh, diskotekash, lojra argetuese per femije, qender sportive, qendra pushimi e kurative.
- Tregetimin e karburanteve te ndryshem me pakice, si dhe vajrave lubrifikante, te gazit te lengshem per ngrohje, pajisje ngrohese gazi si dhe mbushjen e bombolave te gazit dhe tregetimin e tyre me pakice.

Neni 4

- Shoqeria "BIG BELSHI" Sh.p.k. ka seline e saj ne adresen: *Belsh- Qender, Zona kadastrale 1147, me nr. Pasurie 28/20/1, Belsh, Elbasan.*

Neni 5

Kapitali themeltar i Shoqerise "Big Belshi" Sh.p.k. do te jete **5.000.000 (pese milione) leke** dhe eshte i perbere nga shuma ne te holla e derdhur nga ortakët.

Neni 6

Palet kontraktuese kane rene dakort te percaktojne kuoten e pjesmarrjes te seicilit ortake si me poshte:

1. Shoqeria "BIGALB GROUP" sh.p.k..... 1 kuote me vlere te pergjithshme **2.550.000 leke (dy milione e peseqind e pesedhete mije)** qe perben **51%** (pesedhete e nje) te kapitalit themeltar te shoqerise.
2. Robert Hoxha,1 kuote me vlere te pergjitheshme **2.450.000 leke (dy milione e katerqind e pesedhete mije)** qe perben **49 % (dyzete e nente)** te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 7

Kohezgjatja e shoqerise "Big Belshi" Sh.p.k. do te jete me afat te pacaktuar. Ajo mund te shperbehet ne cdo kohe me vendim te asamblese se ortakëve.

Neni 8

I gjithe kapitali i vene nga te dy ortakët themelues eshte teresisht dhe plotesisht i shlyeshem dhe i nenshkrueshem nga ana e tyre.

Neni 9

Ne librin e llogarise qe do te krijohet ne Shoqerine Tregtare do te shenohet dhe kapitali i derdhur nga te dy ortaket. Rritja e kapitalit themelor te shoqerise nuk eshte e kufizuar.

Neni 10

Te ardhurat e realizuara nga shoqeria do te ndahen pjeserisht ose totalisht ndermjet ortakeve sipas kuotave te tyre te pjesmarrjes ne kapitalin themeltar si dhe nepermjet akteve te tjera noteriale apo kontratave te punes qe ata do te realizojne, pasi te jete lene nje shume menjane te pakten sa nje e njezeta e tij e cila destinohet per formimin e fondit rezerve.

Neni 11

Ne kohen e prishjes se shoqerise ose te perfundimit te afatit, kur nuk ka zgjatje afati, kapitali i shoqerise, pasi te hiqen debite e saj do te ndahet proporcionalisht ndermjet ortakeve sipas kuotave te pjesemarrjes ne kapitalin themeltar.

Neni 12

Fitimi i realizuar nga veprimtaria ekonomike e shoqerise, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore dhe ato qe kane lindur me te tretet, eshte plotesisht i transferueshem dhe per tu depozituar ne nje nga Banka Shqiptare, ose per tu perdorur sipas nevojave te ortakeve te shoqerise.

Neni 13

Ortaket kane keto te drejta dhe detyra themelore:

- te derdhin kuoten e kapitalit baze sikunder eshte percaktuar ne nenin 6,
- te marrin pjese ne drejtimin e shoqerise,
- te terheqin fitimin e realizuar,
- te terheqin aktivin resultant nga bilanci i likuidimit ne rast te pushimit te aktivitetit te shoqerise,
- te ruajne sekretin e aktivitetit te shoqerise,
- te impenjohen per arritjen e objektivave te shoqerise.

Neni 14

Organet e shoqerise "**Big Belshi**" Sh.p.k. jane:

- Asambleja e Ortakeve te shoqerise
- Administratori i shoqerise.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit te tyre do te percaktohen ne statutin e shoqerise Administrator i shoqerise do te jete **Z. Admir SHKEMBI**, per nje afat 5 vjecar.

Neni 15

Shoqeria tregtare private "**Big Belshi**" Sh.p.k. eshte person juridik shqiptetar dhe do te ushtroje veprimtarine e saj ekonomike private ne baze te legjislacionit shqiptetar ne fuqi dhe vecanerisht ligji 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe ligji Nr.9723 date

03.05.2007 "Per regjistrimin e biznesit" i ndryshuar, te K. Civil si dhe te akteve ligjore dhe nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

Neni 16

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit, qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te ligjit Nr.7961, date 12.07.1995 (KODIT TE PUNES), si dhe akteve te tjera ne zbatim te tij.

Neni 17

Mosmarreveshjet e mundeshme qe mund te lindin gjate interpretimit apo zbatimit te kesaj kontrate palet do ti zgjidhin ne rruge miqesore, ne te kundert kompetencat per zgjidhjen e konfliktit i kalon Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.

Neni 18

Per sa nuk pershkruhet ne kete kontrate themelimi do te aplikohen nenet e statutit te shoqerise dhe dispozitat e legjislacionit shqipetar.

Neni 19

Ky Akt-themelimi eshte perpiluar ne tre kopje origjinale.

Date 16, 01, 2019

ORTAKET THEMELUES

Shoq. "BIGALB GROUP" Sh.p.k.

Perfaqesuese Ligjore

Elona KOSHI



ROBERT HOXHA

